



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT**

**KËSHILLI I GJYKATËS**

Nr. 2191 prot.

Tiranë, më 02.05.2024

**V E N D I M**

Nr. 23, datë 02.05.2024

**PËR EMËRIMIN E ZNJ. IVI HALIPAJ NËPUNËS CIVIL GJYQËSOR, NË  
KATEGORINË EKZEKUTIVE, SPECIALISTE E BURIMEVE NJERËZORE, NË  
SEKTORIN E BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE  
PROKURIMEVE**

Këshilli i Gjykatës Administrative të Apelit, i përbërë nga:

<b>Ardian DVORANI</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Blerona HASA</b>	<b>Anëtare Zëvendësuese</b>
<b>Leonard STRATAJ</b>	<b>Kancelar</b>

Këshilli i Gjykatës, në mbështetje të nenit 57 të Ligjin nr.98, datë 06.10.2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si edhe të pikës 1 të nenit 13 dhe të nenit 14 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.622, datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", si edhe të vendimit nr. 22, datë 23.04.2024 të Këshillit të Gjykatës,


**V E N D O S I:**

1. Emërimin e Znj. Ivi Halipaj nëpunës civil gjyqësor, në kategorinë ekzekutive, Specialist i Burimeve Njerëzore në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve.

2. Znj. Ivi Halipaj të kryejë dorëzimet e detyrës për pozicionin aktual në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga nxjerrja e këtij vendimi.
3. Ky vendim, së bashku me relacionin shoqërues dhe aktet e tjera të procedurës së plotësimit të këtij pozicioni, i njoftohet kandidates fituese dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, si edhe publikohet në faqen elektronike të Gjykatës.
4. Ngarkohet Kryetari i Gjykatës dhe Kancelari për zbatimin e këtij vendimi.


**KANCELARI**

**Leonard STRATAJ**



**ANËTARE**

**Blerona HASA**



**ZËVENDËSKRYETARI**

**Ardian DVORANI**

